

VENDIM
Nr. 46, datë 3.7.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE TË
BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar; kreut II, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 2, pas paragrafit “Ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit””, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“- Ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.”;

b) Në nenin 4, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, pas togfjalëshit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, shtohet togfjalëshi “, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”;

ii) Në pikën 2, pas shkronjës “e”, shtohen shkronjat “f”, “g” dhe “h”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“f. **aksione të mbajtësit (bearer shares)**, janë aksione të një personi juridik, pronësia e të cilave i kalon personit që zotëron/mban certifikatën/dokumentin e aksioneve të mbajtësit, pa pasur nevojë për marrëveshje/kontratë për kalimin e pronësisë së këtyre aksioneve;

g. **aksioner përfaqësues (nominee shareholder)**, është aksioneri i regjistruar i një personi juridik, që mban aksionet në emër të aksionerit aktual (pronarit përfitues), në bazë të një marrëveshjeje;

h. **bankë guaskë**, është një bankë, e cila nuk ka prani fizike, përfshirë mungesën e administrimit e drejtimit, si dhe nuk është e përfshirë në një grup të rregulluar financiar.”;

c) Në nenin 5, pika 2, fjala “legalizuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “noterizuar”;

d) Në nenin 7, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, shkronja “a”, togfjalëshi “reputacionin e të paktën dy drejtuesve ekzekutivë të propozuar të subjektit”, zëvendësohet me togfjalëshin “reputacionin e drejtuesve ekzekutivë të bankës së propozuar”;

ii) Në pikën 1, shkronja “c”, togfjalëshi “kur aksionerët e drejtpërdrejtë janë persona juridikë”, zëvendësohet me togfjalëshin “kur aksioneri i drejtpërdrejtë është person juridik”;

iii) Në pikën 1, shkronja “c”, nënpika “iv”, togfjalëshi “përfaqësuesi ligjor i saj”, zëvendësohet me togfjalëshin “përfaqësuesi ligjor i tij”;

iv) Përmbajtja e pikës 1, shkronja “c”, nënpika “v”, ndryshon si më poshtë:

“v. *strukturën e kapitalit të aksionerit të propozuar, deri në përfituesin e fundit me pjesëmarrje influencuese dhe joinfluencuese në kapitalin e bankës, (sipas formularëve nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, pjesë e kësaj rregulloreje). Në informacionin sipas kësaj shkronje duhet të deklarohen nëse kjo strukturë përmban ose jo aksione të mbajtësit (bearer shares), ose aksioner përfaqësues (nominee shareholder)*”;

v) Përmbajtja e pikës 1, shkronja “c”, nënpika “vi”, ndryshon si më poshtë:

“vi. pjesëmarrjet e aksionerit të propozuar në shoqëritë në të cilat zotëron jo më pak se 10 (dhjetë) për qind të të drejtave të votës (në qoftë se është e aplikueshme), të shoqëruar me një përmbledhje të veprimtarisë/ve që këto të fundit kryejnë,”;

vi) Përmbajtja e pikës 1, shkronja “c”, nënpika “viii”, ndryshon si më poshtë:

“viii. të dhëna për veprimtarinë tregtare për shtatë vitet e fundit të aksionerit që propozon të zotërojë pjesëmarrje influencuese, si dhe pasqyrat financiare të audituara, të tre viteve të fundit, për çdo aksioner, që tregojnë se natyra dhe burimet financiare të aksionerit të propozuar janë të tilla që mund të sigurojnë mbështetje me kapital shtesë të veprimtarisë së bankës, si dhe evidencën e mjaftueshmërisë së mjeteve monetare në dorë dhe në banka, për pagimin e kapitalit, sipas formularit nr. 12 (faqe 4), pjesë e kësaj rregulloreje,”;

vii) Në pikën 1, shkronja “c”, nënpika “ix”, togfjalëshi “për aksionerët e propozuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “për aksionerin e propozuar”, si dhe fjalia e fundit, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.”;

viii) Në pikën 1, shkronja “c”, pas nënpikës “ix”, shtohen nënpikat “x”, “xi” dhe “xii”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“x. deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (formulari 15).

xi. listën e pjesëmarrjeve të tërthorta në kapitalin e bankës, në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind, të shoqëruar me informacionin e mëposhtëm:

- dokumentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si person/a juridik/ë dhe statutin/et e shoqërisë/ve,
- dokumentacionin përkatës se nuk ka/në detyrime fiskale të prapambetura për t’u paguar për periudhën më të fundit,

- deklaratën noteriale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj të tretëve,

- vërtetime, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit përkatës, se:

- personi nuk është në ndjekje penale (kur është e aplikueshme),

- personi nuk është në gjykim për vepra penale (kur është e aplikueshme),

- personi nuk është i dënuar penalisht (kur është e aplikueshme),

- personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera,

- ndaj personit nuk kanë filluar procedura të paafitësisë paguese, të falimentimit ose të likuidimit etj.;

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.

- deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (formulari 15).

xii. listën e përfituesve të fundit individë në kapitalin e bankës, në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind, të shoqëruar me informacionin e mëposhtëm:

- kopje të noterizuar/legalizuar të dokumentit të identifikimit dhe një CV (sipas formularit nr. 6, pjesë e kësaj rregulloreje),

- informacione për lidhje familjare me aksionerët e bankës,

- dokumentacionin ligjor përkatës se nuk ka detyrime fiskale të prapambetura për t’u paguar për periudhën më të fundit,

- deklaratë për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj të tretëve (në qoftë se ka),

- vërtetime të lëshuara nga organet kompetente se:

- personi nuk është në ndjekje penale,

- personi nuk është në gjykim për vepra penale,

- personi nuk ka qenë dënuar ndonjëherë penalisht,

- personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera,

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.

- deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (formulari 15).”;

ix) Në pikën 1, shkronja “d”, togfjalëshi “*kur aksionerët e drejtpërdrejtë janë persona fizikë/individë*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*kur aksioneri i drejtpërdrejtë është person fizik/individ*”;

x) Përmbajtja e pikës 1, shkronja “d”, nënpikat “i” dhe “ii”, ndryshon si më poshtë:

“i. *kopje të noterizuar/legalizuar të dokumentit të identifikimit dhe një CV (sipas formularit nr. 6, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje),*

“ii. *informacion të plotë për interesat pasurorë apo të biznesit/ve të tij, veçanërisht listën e bizneseve ku ai mund të ketë pjesëmarrje influencuese dhe për çdo pjesëmarrje të tillë, përqindjen e aksioneve/kuotave që zotëron në kapitalin aksioner,*”;

xi) Pas pikës 1, shkronja “d”, nënpika “ii”, shtohet nënpika “ii/1”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“ii/1. *pasqyra/të dhëna financiare të audituara nga audituesit ligjorë (sipas formularit nr. 12, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje). Në rastin kur propozon të zotërojë pjesëmarrje influencuese, të dhëna për veprimtarinë tregtare për shtatë vitet e fundit,*”;

xii) Në pikën 1, shkronja “d”, nënpikat “iii”, “iv” dhe “v”, togfjalëshi “*për pjesëmarrjen e tyre*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*për pjesëmarrjen/t e tij*”;

xiii) Në pikën 1, shkronja “d”, nënpika “vi”, togfjalëshi “*aktivitetit të tyre privat*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*aktivitetit të tij privat*”;

xiv) Përmbajtja e pikës 1, shkronja “d”, nënpika “vii”, ndryshon si më poshtë:

“vii. *deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (formulari 15),*”;

xv) Në pikën 1, shkronja “d”, nënpika “x”, fjalja e fundit, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“*Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.*”;

xvi) Në pikën 1, shkronja “e”, nënpika “vi”, pas togfjalëshit “*cash flow*”, shtohet togfjalëshi “*(sipas formularëve nr. 7, nr. 8, nr. 9 dhe nr. 10, pjesë e kësaj rregulloreje)*”;

xvii) Në pikën 1, shkronja “e”, nënpika “vii”, pas togfjalëshit “*gjatë zbatimit të planit të biznesit*”, shtohet togfjalëshi “*duke përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit,*”;

xviii) Në pikën 3, shkronja “e”, togfjalëshi “*nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit (shoqëritë ratings, nëse ka)*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*nga institucionet e jashtme të vlerësimit të kredisë (ECAI) (nëse ka)*”;

xix) Në pikën 3, shkronja “f”, pas togfjalëshit “*gjendjen financiare të bankës së huaj*”, shtohet togfjalëshi “*, mbi baza individuale dhe të konsoliduara, në rastet kur ajo është pjesë e një grupi bankar/financiar*”;

xx) Në pikën 3, pas shkronjës “g”, shtohen shkronjat “h” dhe “i”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“h) *politikën dhe procedurat për administrimin e rrezikut të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit të bankës së huaj;*

i) *raportimet e bankës së huaj për numrin e transaksioneve të dyshimta, si dhe numrin e klientëve sipas kategorive të rrezikut, për 3 vitet e fundit.*”;

e) Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 4, shkronja “e”, pas togfjalëshit “*kapitalit dhe strukturën e tij*”, shtohet togfjalëshi “*si dhe informacionin mbi lidhjet e mundshme familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, të cilët mund të financojnë aksionerin e propozuar,*”;

ii) në pikën 5, pas shkronjës “d”, shtohen shkronjat “e” dhe “f” me përmbajtjen e mëposhtme:

“e. numrit të transaksioneve të dyshimta dhe numrit të klientëve sipas kategorive të rrezikut, të bankës së huaj, për 3 vitet e fundit;

f) sanksioneve të vendosura për bankën e huaj nga autoritetet mbikëqyrëse/përgjegjëse, përfshirë edhe në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, gjatë 3 viteve të fundit.”;

iii) në pikën 6, togfjalëshi *“bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, Drejtorinë e Tatim Taksave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës etj.”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar dhe për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Tatim Taksave, etj.”;*

iv) pas pikës 6, shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:

“7. Në rast se Banka e Shqipërisë konstaton, apo ka dyshime të arsyeshme se struktura e kapitalit apo burimi i tij lidhet me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, që kanë lidhje familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me aksionerët e propozuar, apo lidhet me shoqëri të regjistruara në parajsë fiskale ose offshore, njofton dhe kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nëse ka informacion në lidhje me aksionerët e propozuar, si dhe pezullon procedurën e licencimit deri në një përgjigje nga kjo e fundit.”;

f) Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me përmbajtjen e mëposhtme:

“; dhe

e. politika dhe procedurat e brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit adresojnë rreziqet e identifikuara në kuadrin e sistemit të administrimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit”;

ii) pas pikës 2, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2/1. Përveç sa është parashikuar në nenin 19, pika 3 të ligjit për bankat, Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës, edhe nëse bazuar në vlerësimet e saj, gjykon se:

a) licencimi do të cenonte interesat e publikut;

b) aksionerët e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të bankës së propozuar, zotërojnë aksione të mbajtësit (bearer shares), ose janë aksionerë përfaqësues (nominee shareholders);

c) banka që parashikohet të licencohet ose aksionerët e propozuar të saj, kanë një strukturë komplekse të pronësisë dhe kontrollit;

d) aksioneri i propozuar i bankës së propozuar, është një bankë guaskë;

e) aksionerët e bankës së propozuar paraqesin rreziq të lartë.

2/2. Banka e Shqipërisë në asnjë rast nuk lejon krijimin apo vazhdimin e veprimtarisë së një banke guaskë.”;

iii) në pikën 3, pas togfjalëshit *“paraprak për licencë,”*, shtohet togfjalëshi *“me arsyet përkatëse,”*;

g) Në nenin 11, pika 1, shkronja “b”, togfjalëshi *“Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”*, zëvendësohet me togfjalëshin *“Qendrës Kombëtare të Biznesit”*;

h) Në nenin 14, pika 1, pas shkronjës “e”, shtohen shkronjat “f”, “g” dhe “h” me përmbajtjen e mëposhtme:

“f. një përshkrim të rreziqeve ndaj të cilave banka parashikon të ekspozohet gjatë zbatimit të planit të biznesit, duke përfshirë dhe rrezikun e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit;

g. një përshkrim të sistemeve të kontrollit që zbatohen për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në degën ose agjencinë, si edhe të procesit të monitorimit dhe raportimit të transaksioneve të dyshimta;

h. një përshkrim të përgjegjësiave të personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në degën ose agjencinë që parashikohet të hapet.”;

i) Neni 15 shfuqizohet;

j) Në nenin 16, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshon si më poshtë:

"1. Banka, që kërkon të hapë degë, filial, agjenci ose zyrë përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, merr miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë dhe i paraqet një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:"

ii) Në pikën 1, shkronja "a", pas nënpikës "xi" shtohen nënpikat "xii", "xiii", "xiv" "xv" me përmbajtjen e mëposhtme:

"xii. informacion mbi mjaftueshmërinë e rregullave dhe procedurave të kontrollit të brendshëm dhe të funksionit të përputhshmërisë së bankës, për mbulimin e funksioneve të kontrollit të veprimtarisë së degës ose agjencisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

xiii. informacion për kushtet ekonomike dhe politike të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të dega ose agjencia;

xiv. vlerësim të tipareve të sistemit bankar dhe/ose financiar të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të dega ose agjencia;

xv. informacion për skemën e mbikëqyrjes bankare në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të dega ose agjencia;"

iii) Në pikën 1, shkronja "b", togfjalëshi "përveç kërkesave i, ii, iii dhe v të shkronjës "a" të këtij neni", zëvendësohet me togfjalëshin "përveç kërkesave i, ii, iii, v dhe xii të shkronjës "a" të këtij neni";

iv) Përmbajtja e pikës 1, shkronja "b", nënpika "ii", ndryshon në:

"ii. informacion për drejtuesit kryesorë të filialit,"

v) Në pikën 1, shkronja "b", pas nënpikës "iv", shtohen nënpikat "v", "vi", "vii" dhe "viii" me përmbajtjen e mëposhtme:

"v. informacion për legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit që zbatohen në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filiali;

vi) informacion për kushtet ekonomike dhe politike të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filiali;

vii) vlerësim të tipareve të sistemit bankar dhe/ose financiar të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filiali;

viii) informacion për skemën e mbikëqyrjes bankare në vendin ku do të ushtrojë veprimtarinë/ të filiali."

vi) Në pikën 2, shkronja "d", pas togfjalëshit "dega, agjencia ose filial", shtohet togfjalëshi "si dhe të pengesave ligjore për sigurimin e informacioneve prej degës, agjencisë ose filialit, që lidhen me vlerësimin e rreziqeve, duke përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe me statistikën mbi raportimin e transaksioneve të dyshimta";

vii) Në pikën 2, pas shkronjës "d", shtohen shkronjat "e" dhe "f" me përmbajtjen e mëposhtme:

"e) rreziqeve sektoriale dhe të vendit, të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe vlerësimet e vendit nga organizmat ndërkombëtare (për shembull, komiteti i ekspertëve të Moneyval etj.);

f) aftësisë së bankës për të integruar sistemet e administrimit të rreziqut, kontrollit dhe përputhshmërisë në nivel grupi, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.";

viii) Përmbajtja e pikës 3 ndryshon në:

"3. Banka e Shqipërisë, jep miratimin paraprak për realizimin e zgjerimit të bankës jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm kur krijon bindjen se pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur sipas shkronjës "a" dhe/ose "b", të pikës 1 të këtij neni dhe bazuar në analizën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, janë plotësuar kriteret e pikës 2, shkronja "a", të nenit 14 të kësaj rregulloreje.";

k) Në nenin 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, 2 dhe 3, kudo ku gjendet fjala "influencuese", pas saj shtohet togfjalëshi "të drejtpërdrejtë ose të tërthortë";

ii) Pika 2, shkronja "e", shfuqizohet;

iii) Pika 2, shkronja "g", ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"g. pëlqimin e autoritetit mbikëqyrës të vendit të origjinës për zotërimin e kësaj pjesëmarrjeje influencuese, kur personi që kërkon zotërimin ose ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë është një bankë e huaj ose institucion financiar i huaj i licencuar.";

iv) Në pikën 2, pas shkronjës “h”, shtohet shkronja “i”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“i. në rastin kur personi që kërkon zotërimin ose ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, është një bankë apo subjekt financiar jobankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë, do të paraqitet vetëm dokumentacioni i kërkuar në shkronjat “a”, “c”, “d” dhe “h” të kësaj pike”;

v) në pikën 4, togfjalëshi “bashkëpunon dhe kërkon informacion nga institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, Drejtorinë e Tatim Taksave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës etj..”, zëvendësohet me togfjalëshin “bashkëpunon dhe kërkon informacion nga institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar dhe për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Tatim Taksave, etj.”;

vi) pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Banka e Shqipërisë gjatë vlerësimit sipas pikës 4 të këtij neni, zbaton edhe përcaktimet e pikës 7 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.”;

vii) pas pikës 5, shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“6. Banka e Shqipërisë, përveç sa parashikohet në nenin 25 të ligjit për bankat refuzon transferimin e pjesëmarrjes influencuese, nëse konstaton se aksioneri i propozuar:

a) zotëron aksione të mbajtësit (bearer shares), ose është aksioner përfaqësues (nominee shareholder); ose

b) është bankë guaskë ose i lidhur me një bankë guaskë.”;

c) ka një strukturë komplekse të pronësisë dhe kontrollit;

d) aksionerët e bankës së propozuar paraqesin rrezik të lartë.

l) Në nenin 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, pas shkronjës “a”, shtohet shkronja “a/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“a/1) relacionin shoqëruar për rritjen e kapitalit.”;

ii) Në pikën 2, shkronja “d”, pas togfjalëshit “deklaratën noteriale”, shtohet togfjalëshi “të aksionerit/ëve përfitues”;

iii) Në pikën 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“e) vërtetime, për aksionerët përfitues, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit përkatës, se:

i) personi nuk është në ndjekje penale (kur është e aplikueshme),

ii) personi nuk është në gjykim për vepra penale (kur është e aplikueshme),

iii) personi nuk është i dënuar penalisht (kur është e aplikueshme),

iv) personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera,

v) ndaj personit nuk kanë filluar procedura të paafëtisë paguese, të falimentimit ose të likuidimit, etj. (kur është e aplikueshme).

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së njoftimit në Bankën e Shqipërisë.”;

iv) Në pikën 5, shkronja “c”, nënpika “ii, togfjalëshi “nuk është “i dobët”“, zëvendësohet me togfjalëshin “është “i dobët”“;

m) Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 2, pas togfjalëshit “nga banka përthithëse” shtohet togfjalëshi “(sipas formularit nr.1/1, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje)”;

ii) Në pikën 2, pas shkronjës “i”, shtohet shkronja “j” me përmbajtjen e mëposhtme:

“j. një përshkrim të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bankës përthithëse, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të bashkimit me përthithje, dhe të mënyrës se si sistemet e administrimit të rreziqut do të integrohen brenda një afati kohor të arsyeshëm.”;

n) Në nenin 21 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 2, pas togfjalëshit “bankat ekzistuese”, shtohet togfjalëshi “(sipas formularit nr.1/1, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje)”;

ii) Në pikën 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me përmbajtjen e mëposhtme:

“e) një përshkrim të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve të bankës së re, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të bashkimit me krijim, dhe të mënyrës se si sistemet e administrimit të rreziqut do të integrohen brenda një afati kohor të arsyeshëm.”;

o) Në nenin 22 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 2, pas togfjalëshit “banka që po ndahet”, shtohet togfjalëshi “(sipas formularit nr.1/1, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje)”;

ii) Në pikën 2, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “f” me përmbajtjen e mëposhtme:

“f) një përshkrim të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve të bankave të reja pritëse, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të ndarjes me krijim.”;

p) Në nenin 23 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 2, pas togfjalëshit “banka që ndahet”, shtohet togfjalëshi “(sipas formularit nr. 1/1, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje)”;

ii) Në pikën 2, pas shkronjës “i”, shtohet shkronja “j” me përmbajtjen e mëposhtme:

“j) një përshkrim të mjaftueshmërisë së sistemit të administrimit të rreziqeve të bankave pritëse, përfshirë edhe rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme që mund të shtohen gjatë procesit të ndarjes me përthithje.”;

q) Në kreun VI “Dispozita përfundimtare”, pas nenit 24 shtohet neni 24/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 24/1

Procesi i rivlerësimit të aksionerëve

1. Bankat kryejnë rivlerësimin e përshtatshmërisë së aksionerëve të miratuar nga Banka e Shqipërisë, të paktën një herë në vit, si dhe në rastet kur gjykohej e nevojshme, bazuar në rrethana apo fakte të veçanta.

2. Bankat, nëpërmjet procesit të rivlerësimit të përshtatshmërisë së aksionerëve të miratuar, sigurojnë plotësimin në vazhdimësi, të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë rezultatet e procesit të rivlerësimit, mbi baza vjetore, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Bankat dokumentojnë procesin e rivlerësimit të përshtatshmërisë së aksionerëve, si dhe parashikojnë detyrimin për të gjithë aksionerët, të cilët duhet të njoftojnë bankën për çdo rrethanë apo fakt që ka ndikim të rëndësishëm në përshtatshmërinë e tyre ose të konfirmojnë, të paktën një herë në vit, që nuk kanë ndryshuar të dhënat mbi të cilat është dhënë miratimi paraprak nga Banka e Shqipërisë.

4. Në rastet kur bankat konstatojnë mosplotësimin e kushteve nga aksionerët, për të cilët është dhënë miratimi paraprak, njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë, por jo më vonë se brenda 5 ditëve pune nga konstatimi.

5. Banka e Shqipërisë, pas njoftimit sipas pikës 4 të këtij neni, por edhe nëse e konstaton këtë fakt gjatë ushtrimit të procesit të saj mbikëqyrës, vlerëson nëse mund të marrë masat e përcaktuara në pikën 8 të nenit 25 të ligjit për bankat.”;

r) Në nenin 25, togfjalëshi “të parashikuara në ligjin për bankat”, zëvendësohet me togfjalëshin “të parashikuara në kreun VI të ligjit për bankat”;

s) Në formularin nr. 5, pas tabelës, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në informacionin sipas formularit nr. 5, duhet të deklarohet nëse struktura e aksionerëve të bankës përmban apo jo aksione të përmendura në shkronjat “f” dhe “g” të pikës 2 të nenit 4 të kësaj rregulloreje.”;

t) Pas formularit 14, shtohet formulari 15, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Rregullat e parashikuara sipas përcaktimeve të këtij vendimi, do të zbatohen vetëm për procedurat e nisura pas hyrjes në fuqi të tij.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç shkronjës “q” të pikës 1 të këtij vendimi, e cila hyn në fuqi më datë 31.12.2019.

KRYETAR
Gent Sejko

ANEKSI 1

“FORMULARI NR.15

DEKLARATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se kam/nuk kam lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Shënim. Në rastin kur aksioneri i propozuar deklaron se ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, rendit në vijim emrat e personave.

Nr.	Emri i personit të lidhur me aksionerin e propozuar	Lloji i lidhjes (familjare apo marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore), duke e specifikuar	Ka dënim penal të formës së prerë (sqaro llojin e dënimit)
1			
2			
3			
...			

Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë, Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë miratimin tim si aksioner i Bankës _____, në kërkesë dhe në atë shkallë, që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Emri/mbiemri i aksionerit të propozuar)

_____/_____/_____
(Data)

(nënshkrimi i plotë)”.
